



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar sot, më datë **30.07.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Marrjen në pyetje të personit të personit të arrestuar dhe verifikimin e kushteve dhe nevojave të sigurimit për personin nën hetim **Aurel Zarka**, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*”, e kryer tre herë, e kryer në bashkëpunim dy herë, të parashikuar nga nenet 245/1, paragrafi (2) dhe 25 të Kodit Penal (para ndryshimeve me ligjin nr.43/2021); “*Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë*”, e kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 319 dhe 25 të Kodit Penal; “*Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë*”, të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal”.

2. Bazuar në nenin 248 pika 1 të K.Pr.Penale, seanca gjyqësore për shqyrtimin e kësaj kërkesë do të zhvillohet më datë **31.07.2024 ora 12:00**.

Tiranë, më datë 30.07.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar